



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**  
Mbledhja nr.05/2017  
Prishtinë, më 7.11.2017, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Sala Berisha – Shala, kryetare, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari – Lila, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

**Munguan:** Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Dardan Molliqaj, Qëndron Kastrati, Memli Krasniqi dhe Gani Dreshaj anëtarë.

**I ftuar:** Bajram Hasani, ministër i Tregtisë dhe Industrisë.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Etleva Malushaj –GPP/LVV, Semra Çitaku – Ambasada e Britanisë, Dardan Abazi – INDEP, Ismail Shabani – Kosoava Press.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

**Mbledhjen e kryesoi:** Sala Berisha - Shala, kryetare e Komisionit.

**Në këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Raportim i ministrit së Tregtisë dhe Industrisë z.Bajram Hasani, në lidhje me prioritetet e Ministrisë;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;**
- 4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-019 për Standardizim;**
- 5. Të ndryshme;**

*Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës;**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Raportim i ministrit të Tregtisë dhe Industrisë z.Bajram Hasani, në lidhje me prioritetet e Ministrisë;**

**Sala Berisha-Shala, kryetare e Komisionit**, tha që edhe në Planin e Punës së Komisionit kemi paraparë raportimin e ministrave të linjës. Në këtë mbledhje sot është i ftuar për raportim ministri i Tregtisë dhe Industrisë z. Bajram Hasani, për të na njoftuar në lidhje me prioritetet e ministrisë.

**Bajram Hasani, ministër i Tregtisë dhe Industrisë**, pasi përshëndeti deputetët dhe pjesëmarrësit tjerë në mbledhje, i paraqiti në mënyrë kronologjike prioritetet e ministrisë si vijon, që janë në kuadër të programit të Qeverisë 2017-2021. Programi orientohet në gjashtë qëllimet kryesore: zhvillimi i konkurrueshmërisë së sektorit privat, përmes zhvillimit industrial dhe përmirësimit të mjedisit të të bërit biznes; inkurajimi i investimeve dhe eksportit përmes fuqizimit të kapaciteteve dhe të pakos stimuluese; zhvillimi dhe promovimi i infrastrukturës së cilësisë, duke e përafuar legjislacionin, anëtarësimi në organizatat relevante evropiane dhe ndërkombëtare; mbikëqyrja e tregut dhe mbrojtja e konsumatorit; avancimi i mëtejme i politikave tregtare; mbrojtja e produkteve vendore; rritja e rezervës shtetërore të mallrave. Masat e parapara në Programin 2017 – 2021 janë të rëndësishme ngase, përveç tjerash, kanë të bëjnë me zotimin e Ministrisë që të implementojë politika më rigorozë në mbështetje të ndërmarrjeve, duke menduar në: përmirësimin e mëtejme të ambientit të të bërit biznes, promovimin dhe nxitjen e investimeve, duke paraparë ngritje të bashkëpunimit me diasporën dhe vendet tjera si dhe shtim të mëtejme të aktiviteteve promovuese, përmirësimin e kujdesit ndaj investitorëve, zhvillimin dhe promovimin e turizmit, avancim në mbrojtjen e krijimtarisë së ndërmarrësve (pronësinë industriale), si dhe studime të sektorëve industrialë, duke identifikuar produktet dhe sektorët me potencialë për eksport, përfshirë krijimin dhe zhvillimin e kllasterëve industrialë; përmirësimin e infrastrukturës ligjore dhe të politikave në lidhje me infrastrukturën e cilësisë së produkteve, duke paraparë përmirësimin e shërbimit të akreditimit, standardizimit dhe metrologjisë, mbështetje ndërmarrjeve në implementimin e standardeve gjegjësisht certifikimin e produkteve me standardet relevante, anëtarësim në organizatat e infrastrukturës së cilësisë, duke i dhënë prioritet organizatave evropiane; përmirësimin e mbikëqyrjes së tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit, dhe po ashtu programi parasheh avancimin e politikave tregtare të Kosovës, në raport me vendet tjera, dhe përveç tjerash parasheh përgatitjen për anëtarësim në Organizatën Botërore të Tregtisë. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë punën e vet do ta vazhdojë gjithmonë duke mbetur e përkushtuar në qëllimin e përgjithshëm, për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Republikës së Kosovës.

**Hykmete Bajrami, pyeti** cili është projekti konkret në lidhje me prioritetet e ministrisë që do t'a realizonin? Sa është buxheti për vitin 2018 i MTI-së? Investimet strategjike të parapara me Ligjin për Investimet Strategjike, a kanë kaluar në Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike? A është rritur buxheti për Agjencinë e Promovimit dhe Investimeve të Huaja (KIESA)? Kur do të funksionalizohet operatori mobil për matjen e cilësinë së naftës dhe cilat

janë politikat për naftën? Sa është buxheti i ndarë për zonat ekonomike? Ajo tha se projektet e mira që kanë mbetur në gjysmë, shpreson që të vazhdohen nga udhëheqja e re. Është shqetësuese edhe themelimi i dy ministrive të reja, ajo për Diasporë dhe Investime Strategjike dhe ajo për Inovacion dhe Ndërmarrësi, pasi që bie ndesh me politikat dhe kompetencat e MTI-së.

**Mimoza Kusari-Lila**, ngriti shqetësimin e formimit të dy ministrive të reja, atë për Diasporë dhe Investime Strategjike dhe atë të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Krijimi i këtyre dy ministrive është duke e bërë zvogëlimin e kompetencave të MTI-së. Kusari pyeti se a kanë krijuar mekanizëm koordinues për investimet strategjike, se cila ministri do ti koordinojë këto investime? Marrëveshja CEFTA ende është në kuadër të UNMIK-ut, a ka strategji se si të përfaqësohet Kosova si shtet? Cili është plani konkret për zbatimin e MSA-së dhe cilat janë masat që do të ndërmerren për uljen importeve tregtare?

**Bilall Sherifi**, pyeti: Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë a do t'ia marrin ndonjë departament MTI-së dhe buxheti a është marrë nga MTI-ja për Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe kur do të fillohet në mënyre konkrete të vepohet për kontrollimin e cilësisë së naftës?

**Duda Balje**, pyeti: ju si MTI, a jeni duke e bërë monitorimin për mbrojtjen e konsumatorëve si në të kaluarën dhe cilat janë masat që jeni duke i ndërmarrë? A keni planifikuar zonë industriale edhe për Komunën e Prizrenit ?

**Adem Hoxha**, pyeti se a do te mbulohet edhe komuna e Dragashit më zonën industriale, sepse siç tha ky deri më tani komuna e Dragashit nuk është përfshirë në zonat ekonomike.

**Kryetarja**, kërkoi që të sillen në pako Projektligjet për masat antidamping; tregun e brendshëm; dhe masat mbrojtëse në import, të cilat kanë ndërlidhje në mes veti.

**Bajram Hasani**, u përgjigj në pyetjet dhe çështjet e ngritura nga deputet. Për Ligjin për Investime Strategjike, tha se do të mbetet në kompetencat e MTI-së, pranë Departamentit për Përkrahjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, andaj shumë shpejt do të jetë Ligji për Investime Strategjike. Në lidhje me krijimin e ministrive të reja, Hasani theksoi se ato janë krijuar për detyra të reja për "Start Up" dhe nuk ka përzierje të kompetencave në mes ministrive të reja. Për operatorin e mobil, për matjen e cilësisë së naftës, tha që do ta fillohet më 15 nëntor të aktivizohet laboratorin për cilësinë e naftës. Për zonat ekonomike, tha se ka vazhdimësi të punës, në Komunën Vitisë ka filluar faza e projektit të fizibilitetit, po ashtu, dhe për zgjerimin e Parkut Industrial të Drenasit, andaj zonat ekonomike ato që kanë qenë në proces, janë duke u funksionalizuar. Lidhur më investimet huaja, Hasani theksoi se të gjitha funksionet për investime të huaja mbesin tek KIESA dhe nuk ka bartje të kompetencave. Pra, adresa për investitorë të huaj mbetet Agjencia për Promovimin e Investimeve të Huaja (KIESA), që është në kuadër të MTI-së. Sa i përket CEFTA-së, ai tha se Kosova duhet të paraqitet si shtet në CEFTA, jo në emër të UNMIK-ut, dhe do të shqyrtojnë pozicionin e CEFTA-s, lidhur këtë çështje me 23 të këtij muaj do të marrin pjesë në një takim zyrtar në Serbi dhe do të bëjnë presion për pozicionin e Kosovës në CEFTA. Për politikat tregtare, tha se është prioritet i MTI-së që ti rrisin kapacitetet e ndërmarrjeve që eksportojnë, në mënyrë që të keni balancim në mes

importit dhe eksportit. Për MSA-n, tha që MTI-ja është bartëse e reformave në të udhëhequrit e të bërit biznes, por MSA-ja nuk varet vetëm prej MTI-së. Ka shumë ministri që janë të ndërlidhur me çështjen MSA-së, por MTI-ja në këtë aspekt nuk qëndron keq. Për buxhetin, Hasani tha që shuma e kërkuar nga MTI-ja nuk është ndarë, por presim të rritet pas rishikimit, pasi që MTI-ja ka një fushëveprim shumë të madh. Për mbrojtjen e konsumatorëve, jemi duke bërë fushatë sensibilizimi, e kemi qendrën e thirrjeve telefonik për ti raportuar problemet që hasin konsumatorët gjatë blerjeve, po ashtu, kemi angazhimin e inspektimit nga ana e inspektorëve. Për zonën ekonomike në Prizren, theksoi së ka një kërkesë nga Komuna e Prizrenit, ku janë dy propozime për vend dhe duhet të shkohet në dy lloje, mbetet kjo punë tani të shqyrtohet dhe njëherë me Komunën e Prizrenit. Sa i përket Komunës së Dragashit është problem pak më i madh, por po mundohemi që të fillohet njëherë me komunat më të mëdha dhe me këto mund të shërbehen edhe komunat e vogla, siç është ajo e Dragashit.

**Mimoza Kusari- Lila**, potencoi për CEFTA-n se Qeveria duhet ta ketë një plan konkret se si të veprohet, nëse nuk e keni ndonjë plan të qartë se cilët do të jenë hapat për vendimin për CEFTA-n, atëherë është mirë t'a njoftoni opinionin për marrëdhëniet e Kosovës me CEFTA-n, sepse vitin e ardhshëm Kosova ka të drejtën e kryesimit të saj. Po ashtu, për zbatimin e marrëveshjes së MSA-së, duhet të ndërmerrni hapa më të qartë. Në lidhje me krijimi i ministrive të reja, është krijuara shumë paqartësi në funksionimin e Qeverisë, tha zonja Kusari.

**Hykmete Bajrami**, potencoi se çështje e problemit me CEFTA-n ka filluar edhe nga mandatet e kaluara të MTI-së me "Protokollin 6", ku Kosova nuk ka pranuar që UNMIK-u të nënshkruaj në emër të Kosovës, ky është më tepër një problem politik. Çështja e importit nuk varet vetëm prej MTI-së, duhet të pyetet dhe Ministra e Bujqësisë, sepse e ka buxhetin më të madh për subvencionet e shumë produkteve. Ajo kërkoi sqarim për "Vendimin e importit të miellit" dhe ndikimet e këtij vendimi në çmimin e bukës si dhe pse kjo ministri nuk mori vendim edhe për grurin. Po ashtu, Bajrami kërkoi edhe garanci për çmimin e bukës në këtë drejtim. Ajo tha, që është e papranueshme që Ministra e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, që merret vetëm me "Start Up" e të ketë buxhetin mbi 10 milionë, ndërsa KIESA- 3 milion euro, kur kemi 154 mijë ndërmarrje, ku 103 mijë prej tyre janë tatimpagues, sepse duhet t'i përkrahim ndërmarrjet që janë në treg, krahas atyre "Start Up". Kërkoj angazhim më të madh të Ministrisë, në lidhje me "Fondin për Garanci Kreditorë" sepse ka qenë mjaft efikas themelimi i këtij fondi. Në fund kërkoj sqarime shtesë për zbatimin e MSA-së dhe për kontrollin e cilësisë së naftës, sepse nuk dëgjova përgjigje.

**Bajram Hasani**, tha se sa i përket MSA-së, i kemi marr të gjitha hapat, kurse sa i përket MTI-së si për legjislacion ku janë 10 projektligje edhe për masa tjera, dhe në vitin 2018, në pjesën e dytë do të aplikojmë për statusin e vendit kandidat. Hasani tha se masat për "Vendimin e miellit", janë marr për bazë Ligji për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese, dhe duke u konsultuar me Shoqatën e Prodhuesve të Miellit. Dhe kjo masë erdhi si shkas i shpëtimit të Industrisë së Miellit dhe një gjë e tillë lejohet edhe me ligj.

**Hykmete Bajrami**, pyeti pse nuk është marrë masa e njëjtë dhe ndaj importuesve të grurit?

**Bajram Hasani**, potencoi se po të kishim marrë masa dhe ndaj importuesve të grurit atëherë do të ketë rritje të çmimit. Ne jemi të interesuar që në kohën e korrje-shirjeve për një përudhë të

caktuar të marrim masat njëjta edhe për grurin, sikurse ndaj importuesve të miellit, në mënyrë që të i inkurajomë fermerët të rrisin sasinë e të mbjellave të grurit. Sa i përket naftës dhe cilësisë së saj, kemi kërkesë nga ministri Hamza që të ndryshohet vendimi i mëhershëm, por një gjë iu siguroj që do të gjejmë mënyrën dhe formën se si do të punojmë dhe së shpejti do të adresohet kjo çështje, pra do të këtë ndryshim se a do të jetë në trupa inspektuese apo të kthehet në Doganë sepse vetëm 5% të naftës e kontrollojmë.

**Kryetarja,** kërkoi mirëkuptim nga anëtarët komisionit që të kthehen në rendi e ditës, pra për çka është ftuar ministri dhe tha se nëse keni interes, ne për çdo temë mund ta ftojme ministrin në ndonjë mbledhje tjetër.

**Hykmete Bajrami,** tha se është e habitshme kërkesa e ministrit Bedri Hamza, që vendimi të rishikohet, Udhëzimi administrativ 01/2017, e cila e kalon kontrollin e cilësisë të naftës nga trupat inspektuese të Dogana dhe ky proces është pranuar në tërësi nga komplet stafi i Doganës. Dhe nëse ka hy naftë cilësore ndonjëherë, kjo është bërë prejse Dogana e ka në dorë këtë proces sepse trupat inspektuese nuk kontrollojnë cilësi por vetëm kontrollim të dokumentacionit. Ka pas me dhjetëra maune edhe qindra janë kthyer kur këtë kompetencë e ka marr Dogana. Ka pas mospërputhje në mes udhëzimeve administrative, atij të vitit 2012, dhe të vetmit që e kanë kundërshtuar këtë proces kanë qenë trupat inspektuese sepse ka qenë biznesi i tyre. Trupat inspektuese nuk i kanë mbuluar tërë pikat doganore, vetëm disa dhe kemi qenë të pakënaqur më punën e tyre, pra e kemi shtrirë dorën e institucioneve në këtë fushë. Çdo ndryshim tani do ta përkeqësojë gjendjen. Dhe krejt çka duhet tani është që Dogana e Kosovës sepse Ligji për konformitet ua jap këtë kompetencë, duhet të pajiset më një laborator të përmasave që mund ti bëjë analizat e të gjithë indikatorëve, ndryshe çdo veprim tjetër që e keni në plan e përkeqëson gjendjen.

**Bilall Sherifi,** tha kush e ka bërë deri më tani mbështetjen e kompanive “Start Up”? A do të kalojë ndonjë segment i administratës nga MTI-ja në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë? Çmimi i Grurit që vjen nga importi a është i njëjtë si në tregun vendor?

**Mimoza Kusari- Lila,** tha që s’pajtohet më arsyetimin e ministrit sepse po flasim për një ministri, pra ajo e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, që është një ministri e inkubacionit sepse po kujdesët për “Start Up” e jo për ndërmarrje, pra kemi një përzierje të kompetencave, sepse po flas si ish-ministre, pra, e është dobësuar roli i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

**Bajram Hasani,** në lidhje me çmimin e grurit, tha që nuk është rritur në tregun vendor, për këtë prodhuesit vendorë na kanë dërguar një letër falënderimi dhe na kanë thënë që në këtë vit është rritur sasia e të mbjellave me grurë. Për atë se a do ta kalojë ndonjë departament i MTI-së tek Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, tha që nuk kalon asnjë departament, pra nuk ka lëvizje të sektorëve. Lidhur me Fondin për Garancitë Kreditore, ne e kemi kryer obligimin si Ministri dhe ne e shohim me prioritet këtë fond dhe do të vazhdojmë më këtë projekt.

*Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:*

*Përfundim*

*Ministri i Tregtisë dhe Industrisë të raportojë dhe të informojë në vazhdimësi për të gjitha aktivitetet e MTI-së, Komisionin. Ndërsa, Komisioni shprehu gatishmërinë për bashkëpunim dhe përkrahje në miratimin e ligjeve që mbulon kjo ministri.*

### **3.Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-016 për Shoqëritë tregtare;**

**Kryetarja**, i njoftoi anëtarët e Komisionit se Projektligji për Shoqëritë Tregtare, ka qenë dhe nga legjislatura e kaluar i përgatitur për miratim në lexim të dytë, por pasi që u shpërbë Kuvendi, sipas Rregullores së Punës së Kuvendit, është kthyer përsëri në Qeveri. Ndërsa, tani Qeveria e ka sjell në Kuvendi dhe për këtë është i ftuar ministri i Tregtisë dhe Industrisë z.Bajram Hasani, të cilit ia kaloi fjalën.

**Bajram Hasani, ministër i Tregtisë dhe Industrisë**, tha se arsyeja e parë për hartimin e Projektligjit për Shoqëritë Tregtare është adresimi i nevojës për përafrimin e ligjit ekzistues për Shoqëritë Tregtare (me ndryshime dhe plotësime) me legjislacionin e BE-së, në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) dhe Planit të Zbatimit për MSA-n. Arsyeja e dytë për hartimin e Projektligjit për Shoqëritë Tregtare, është rritja e mbrojtjes për investitorët e vegjël në korporata si dhe përmirësimi dhe thjeshtësimi i mëtutjeshëm i procedurave për regjistrimin e shoqërive tregtare, duke u bazuar në kërkesat e Metodologjisë së Bankës Botërore në Raportin për të Bërit Biznes, respektivisht Indikatorët Fillimi i një Biznesi dhe Mbrojtja e Investitorëve të Vegjël. Si çështje me rëndësi të madhe dhe që do të përmirësojë dhe lehtësojë dukshëm ambientin e biznesit në Kosovë, në projektligj është krijuar baza ligjore për krijimin e numrit unik identifikues për shoqëritë tregtare. Sipas kësaj kërkesë, shoqërive tregtare, të cilat regjistrohen në ARBK, i jepet një numër unik i cili identifikon shoqëritë tregtare para të gjitha institucioneve shtetërore të Kosovës, si ARBK, ATK, Dogana e Kosovës, etj. Projektligji për Shoqëritë Tregtare është paraparë në Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA), Planin e Punës të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Programin Legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2017. Projektligji është hartuar në përputhje me procedurat e parapara, me Rregulloren Nr. 09/2011 për Punën e Qeverisë së Kosovës dhe është pranuar Deklarata Financiare nga Ministria e Financave se nuk ka implikime shtesë buxhetore dhe Opinioni i Pajtueshmërisë me Legjislacionin e BE-së nga MIE, se projektligji i lartpërmendur është i harmonizuar me Acquis-in e BE-së. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji në fushën e ekonomisë dhe me qëllim që të përmirësohet ambienti i bërjes së biznesit dhe duke pasur parasysh se projektligji i propozuar është draftuar në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare dhe evropiane, ju propozojmë që t'a shqyrtoni dhe miratoni këtë Projektligj në këtë mbledhje.

**Hykmete Bajrami**, theksoi së po të kishte kaluar Projektligji për Shoqëritë Tregtare në maj të këtij viti, pra para se të shpërbëhej Kuvendi, me siguri që Kosova do të ishte renditur në një pozitë edhe më të mirë në Raportin e Bankës Botërore e të bërit biznes. Ndërsa, disa çështje që rregullon projektligji, si fjala vjen numri unik, tashmë kanë filluar të zbatohen.

*Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:*

## *Përfundim*

- 1. Miratohet në parim Projektligji nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;*
- 2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;*
- 3. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputetja Sala Berisha - Shala, kryetare e Komisionit.*

*Komisioni vendosi që Grupi i Punës për shqyrtimin e këtij projektligji të jetë në përbërje: Hykmete Bajrami, kryesuese, Sala Berisha – Shala dhe Dardan Sejdiu anëtarë;*

### **4.Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-019 për Standardizim;**

**Kryetarja**, kërkoi që po ashtu edhe për Projektligjin për Standardizim që ministri i Tregtisë dhe Industrisë z. Bajram Hasanitë të paraqet ekspozenë e Projektligjit.

**Bajram Hasani, ministër i Tregtisë dhe Industrisë**, theksoi se arsyeja e parë për hartimin e Projektligjit për Standardizim është adresimi i nevojës për përafrimin e ligjit ekzistues për standardizim me legjislacionin e BE-së, në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit (MSA) dhe Planit të Zbatimit për MSA-n. Agjencia Kosovare e Standardizimit është i vetmi organ kombëtar i pavarur standardizues në Kosovë, përgjegjës për plotësimin e nevojave të vendit për standarde teknike, të cilat janë mjet i fuqishëm për ngritje të cilësisë së produkteve dhe shërbimeve. Agjencia Kosovare e Standardizimit është autoritet shtetëror i Notifikimit dhe Pikë e Referimit në Organizatën Botërore të Tregtisë për standarde, siç kërkohet me marrëveshjet relevante ndërkombëtare. Me këtë projektligj parashihet që Agjencia Kosovare e Standardizimit, mund të ofrojë shërbime tjera plotësuese për të përkrahur përdorimin dhe zbatimin e standardeve. Këto shërbime përfshijnë trajnime, informacione dhe certifikime. Ky projektligj është në harmoni me aktet ligjore të BE-së në këtë fushë, respektivisht me Rregulloren 1025/2012, e cila ka hyrë në fuqi me 25 tetor të vitit 2012. Me harmonizimin e Ligjit për Standardizim” me Rregulloren e BE-së 1025/2012, Agjencia Kosovare për Standardizim do t’i plotësoj të gjitha kërkesat dhe do të jetë në nivel të njëjtë me Organizmat tjerë të standardizimit në nivel evropian dhe ndërkombëtarë. Përpos kësaj, avancimi i infrastrukturës ligjore në këtë fushë ka ndikimin e vet praktik, reduktimin e barrierave teknike si në tregun e brendshëm ashtu edhe atë të jashtëm. Projektligji për standardizim është paraparë në Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit-Asociimit (PKZMSA), Planin e Punës të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Programin Legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2017. Projektligji është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren Nr. 09/2011 për Punën e Qeverisë së Kosovës dhe është pranuar Deklarata Financiare nga Ministria e Financave dhe Opinioni i Pajtueshmërisë me Legjislacionin e BE-së nga Ministria e Integritimit Evropian, se projektligji i lartpërmendur është i harmonizuar me Acquis-in e BE-së. Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji dhe duke pasur parasysh nevojën e avancimit të kuadrit ligjor në organizimin dhe funksionimin e standardizimit në Kosovë, ju propozojmë që ta shqyrtoni dhe miratoni këtë Projektligj në këtë mbledhje.

*Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:*

*Përfundim*

- 1. Të miratohet në parim Projektligji nr.06/L-019 për Standardizim;*
- 2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për Standardizim ;*
- 3. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputetja Sala Berisha - Shala, kryetare e Komisionit.*

**5. Të ndryshme.**

**Kryetarja**, i njoftoi anëtarët e Komisionin se për mbledhjen e radhës është i ftuar ministri i Zhvillimit Ekonomik z. Valdrin Lluka, për të njoftuar me prioritetet e Ministrisë dhe për çështjet tjera që janë ngritur nga anëtarët e Komisionit.

**Mbledhja përfundoi në orën 13:00**

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i Komisionit**

**Kryetare e Komisionit,**  
**Sala Berisha – Shala**

---